



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS

NJOFTIM

PËR VEND VAKANT

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR SEKRETAR PRANË PROKURORËVE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, kërkon të punësojë në pozicionin **1 (një) punonjës në administratë me detyrë “Sekretar/e”**.

Bazuar në nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në shkresën nr. 1829 prot, dt.08.09.2020 të Prokurorisë së Përgjithshme,

NJOFTON:

1.Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **1 (një) vende “Sekretar/e”** në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë Durrës.

2.Referuar neneve 68,74,75,76, të ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", kandidatët e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kriteret e veçanta si më poshtë:

Arsimi, trajnimi dhe eksperiencia:

1. Kushtet e përgjithshme:

Të jetë shtetas shqiptar;

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;

Të mos jetë marrë masa disiplinore në marrëdhënie punë dhe/ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit

Të ketë përfunduar ciklin e parë të studimit bachelor në drejtësi dhe ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose fusha të tjera të ngjashme;

2. Kushtet e posaçme:

Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.

Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.

Të ruajë sekretin hetimor.

Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.

Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si Microsoft: Word, Excel, Power Point, etj.

3. Kriteria të preferuara

- a. Të ketë njohje të sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore;
- b. Të ketë kualifike, njohje ose eksperiencë në fushën e zbatimit/ praktikimit të legjislacionit përkatës në fushën e ligjeve organike të drejtësisë si dhe në fushën e arkivave;

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, **deri në datën 06.11.2020 ora 16.00, këto dokumenta:**

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë, master, certifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.

- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht .
- g) Fotokopje te librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, **deri në datën 06.11.2020 ora 16.00.**

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR DURRËS**